



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS PODUJEVË

Numri i lëndës: 2019:198728

Datë: 22.03.2024

Numri i dokumentit: 05492303

P.nr. 135/23

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË - DEGA PODUJEVË - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Besnik Sheqiri, me procesmbajtëse Erblina Aliu, në çështjen penale kundër të pandehurit A. A., për shkak të veprës penale “Furnizimi, transportimi, prodhimi, këmbimi ose shitja e paautorizuar e armëve” nga neni 327 par. 2 lidhur me par. 1 dhe lidhur me nenin 23 të Kodit të përkohshëm penal të Kosovës UNMIK/RREG/2003/25, të akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr. 542-4/2007, të datës 15.04.2008, në rigjykim të çështjes sipas aktvendimit të Gjykatës së Apelit në Prishtinë Departamenti i Krimeve te Renda, PAKR.nr. 266/2019 te datës 14.08.2019, pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor publik, të mbajtur me datë 12.03.2024, në prezencë të palëve: prokurorit të shtetit Menduhi Kastrati dhe mbrojtësit të pandehurit sipas detyrës zyrtare av. A. I. – H., të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 22.03.2024 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

Kundër të pandehurit:

A. A., nga i ati A. dhe e ëma F., data e lindjes ..., në fshatin B., Komuna P., ku edhe banon, letërnjoftimi ..., Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i gjendjes së dobët ekonomike, i martuar, baba i pesë (5) fëmijëve, i pa gjykuar më parë.

Konform nenit 362 par. 1 nën - par. 1.1 të KPP-së,

REFUZOHET AKUZA

Sepse:

Me parë janë furnizuar dhe kane transportuar një sasi të madhe armësh së bashku me te akuzuarin B. A. dhe H. R., me qëllim të shitjes pa autorizim te tyre, ndërsa ne periudhën kohore prej datës 21.07.2007 e deri me datën 01.08.2007 i pandehuri me te akuzuarin B. A. kanë biseduar me telefona celulare lidhur me shitjen e armeve te ndryshme, ndërsa me datën 01.08.2007 rreth orës 16:55 minuta gjatë kontrollimit të shtëpisë së të akuzuarit B. në fshatin B., Komuna e P., policia ka gjetur dhe konfiskuar: një pistoletë “P. B.” G. V. T. Kal. ... mm, nr. ... -mod.... , me nr. serik ..., me një karikator me ... fishekë dhe dy paketime me ... cope fishekë të kal. ... mm dhe ... copë fishekë te pushkës së gjuetisë, një pushke ajrore me nr. serik ..., kurse ne autoservisin "E." ne B. të U., policia ka gjetur dhe konfiskuar: ... Copë fishekë te

kal: ..-mm , ... gëzhoja me mbishkrim "... ", një pistolette "G..." E... .. mm , një pushkë gjuetie "Ch..." me nr. serik ..., ne veture "M..." me targa ... , ne vendin e rregulluar te pragu i derës së parë në anën e djathtë, janë gjetur ... copë fishekë te kal. ... mm dhe një pistoletë "G..." me nr. serik ..., në vendin e rregulluar te pragu i derës së pasme në anën e djathtë të kësaj veture janë gjetur ... pistoleta "G...", ndërsa në bagazhin e kësaj veture janë gjetur ...- pistoleta -te tipit "Z..." te kal. ... mm, dhe ... pistoleta "B..." te kal. ... mm, ... cope fishekë te kal. ... mm, ... cope fishekë me gas, ndërsa në tavanin e shtëpisë se te akuzuarit H. R. ne P., rr. "... " nr. ., gjate bastisjes policia ka gjetur dhe ka konfiskuar ... pistoleta "G..." E... T..., mod. ... mm te kal. ... mm, ... kondak te pushkës së gjuetisë, ... mini kondak te pushkës se gjuetisë "S..." me nr. serik ..., një karikator me shtatë copë fishekë të llojit "S...- E..." mod. ... major , kal. ... mm,, ... cope fishek te kal. ... mm, një pistoletë "Z... " te kal. ... mm me nr. serik ..., një pistoletë "B..." te kal. ... mm, me nr. serik ..., gjashtë paketime me fishekë me gas, gjithsej ... cope fishekë me gas, ... pistoleta "G..." E... të kal.... mm, një pushkë gjuetie ... " C..." me nr. serik ..., një pushkë gjuetie ... "E..." me nr. serik ..., ... paketime me fishekë me gas, gjithsej ... copë fishekë; një karikator i prishur i revoles, dy karikator të pushkës automatike ... e njëri me ... fishekë në të, ... pistoleta "Z." të kal. ... mm , ... pistoleta "G..." E... T..., një paketim me ... copë fishekë të kal. ... mm dhe ... rripa për bartjen e armëve.

- me këtë në bashkëkryerje me te akuzuarit B. A. dhe H. R. kishte për të kryer veprën penale “Furnizimi, transportimi, prodhimi, këmbimi ose shitja e paautorizuar e armëve” nga neni 327 par. 2 lidhur me par. 1 dhe lidhur me nenin 23 të Kodit të përkohshëm penal të Kosovës UNMIK/RREG/2003/25.

- I. Për shkak se Prokurori i shtetit është tërhequr nga akuza në fillim të shqyrtimit gjyqësor.
- II. Shpenzimet e procedurës penale dhe paushallë bien në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, në këtë gjykatë ka paraqitur aktakuzën PP.nr. 542-4/2007, të datës 15.04.2008, kundër të pandehurit A. A., për shkak të veprës penale “Furnizimi, transportimi, prodhimi, këmbimi ose shitja e paautorizuar e armëve” nga neni 327 par. 2 lidhur me par. 1 dhe lidhur me nenin 23 të Kodit të përkohshëm penal të Kosovës UNMIK/RREG/2003/25.

Lidhur me këtë çështje penale, gjykata ka mbajtur seancën e shqyrtimit gjyqësor me datë 12.03.2024, në të cilën prokurori i shtetit pas deklarimit të ekspertit forenzik B. H. - departamenti i imazhit dixhital video – incizim, në kuadër të Agjencisë së Kosovës për Forenzik ka deklaruar se: në këtë shqyrtim gjyqësor në rigjykim të çështjes sikurse edhe në shqyrtimin e kaluar janë administruar prova përfshirë edhe dëgjimin e dëshmitarëve H. R. dhe B. A., nga dëshmitë e te cilëve nuk është arritur te vërtetohet asnjë fakt i implikimit ne kryerjen e veprës penale nga tani i akuzuari A. A., ndërsa nga dëshmitë zyrtare që janë siguruar nga kompania “V...” ka rezultuar se numri telefonik ... ka qene ne shfrytëzim nga personi i quajtur G. A. nga fshati Gj. – Komuna e V., ndërsa numri tjetër telefonit ..., nuk ka pasur të dhëna për shfrytëzuesin e tij qe nga këto dëshmi nuk vërtetohet se këta numra telefonik kane mundur të jenë në shfrytëzim nga i akuzuari A. A..

Nga transkriptet të cilat janë siguruar si provë nga komunikimet në mes të dëshmitarëve H. R. dhe B. A. për veprën penale për te cilën edhe janë gjykuar, gjatë komunikimit në mes tyre

përmendet emri A. por që nuk vërtetohet se është bërë fjalë për të akuzuarin A. A., por që dëshmitari B. A. përmend se është bërë fjalë për personin A. M. për të cilin ka dijeni se është nga D. dhe me të cilin ka punuar në raste të caktuara. Nga sqarimet dhëna në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 12.03.2024 nga eksperti forenzik B. H., nënkuptohet se në raport me audio incizimet si provë materiale e administruar në shqyrtim gjyqësor mund të ofrohet vetëm qartësimi i zërit nga zhurmat në prapavijë, por jo edhe identifikimi i zërit të tani të akuzuarit. Më tej eksperti ka sqaruar se një ekspertize e tillë nuk është bërë ndonjëherë në vendin tonë, dhe në disiplinën e audio Forenzikës sipas ekspertit në fjalë rezultatet nuk janë 100% madje rezultati komentohet në pesë fusha të vendimit 1. mund te jetë, 2. është e përafërt, 3. neutrale, 4. jo e përafërt dhe 5. mund te mos jetë, e nëse i referohemi shkalles me te larte te probabilitetit atëherë mund të mos kemi ndonjë rezultat që do të vërtetonte qartësinë apo saktësinë e zërit në këtë rast të akuzuarit.

Andaj, duke mos pasur asnjë prove konkrete që do të mund të vërtetonte dyshimin e bazuar mirë se i akuzuari A. A. ka kryer veprën penale për të cilën është akuzuar, në kuptim të nenit 51 të KPP-së është tërhequr nga akuza ndaj të akuzuarit A. A. për veprën penale “*Furnizimi, transportimi, prodhimi, këmbimi ose shitja e paautorizuar të armëve*”, nga neni 327 par. 2 lidhur me par. 1 dhe lidhur me nenin 23 të Kodit të përkohshëm penal të Kosovës UNMIK/RREG/2003/25”, dhe të shpall aktgjykim refuzues.

Gjykata ka marrë aktgjykim refuzues me të cilin ka refuzuar akuzën, për shkak se prokurori i shtetit është tërhequr nga akuza në shqyrtim gjyqësor.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale mbështetet në nenin 453 par. 1 të KPP-së.

Nga sa u tha më lartë e në bazë të nenit 362 par. 1 nën-par. 1.1 të KPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË - DEGA PODUJEVË
Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal
P.nr. 135/23, datë 22.03.2024

Procesmbajtëse
Erblina Aliu

Gjyqtari i vetëm gjykues
Besnik Sheqiri

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet Ankesë në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimit të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmes kësaj gjykate.